

## Procesverbal

Nga seanca e I-rë(parë)/2020 e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 30.01.2020, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

### Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga seanca e XI-të/2019 e Kuvendit Komunal...,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Kuvendit Komunal të Dragashit, për vitin 2019 & Planit të Punës, për vitin 2020..., dhe
3. Eventuale...

Seancën, duke përshëndetur delegatët, kryetarin, nënkryetarët, drejtorët e drejtorateve të Komunës, përfaqësuesit e OSCE-së, KDI-së, mediave dhe të tjerët prezent, e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu me kërkesën nëse ka vërejtje apo plotësime të renditë të distës...? Nëse jo, miratohet rendi i ditës-sipas Ftesës...

### Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën ku, pikë të parë, si zakonisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar-XI-të/2019 e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...? Nëse nuk ka, konstatoj se miratuar Procesverbalin e seancës së kaluar.

### Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me pikën e II-të të radhës, ku kemi shqyrtimin dhe miratimin e Raportit të Punës së Kuvendit, për vitin 2019 & Planit të Punës, për vitin 2020, të cilët, si dokument tona, i miratojmë në fillim të vitit, duke analizuar punën e vitit të kaluar dhe planet për vitin vijues. Siç dihet, këto materiale, pasqyrojnë punën dhe aktivitetin tonë, që i kemi pasur me ftesën..., dhe, pa humbur kohë, hapim diskutimet, me qëllim që, në të ardhmen të veprojme ashtu siç parashohin dispozitat kushtetuese e ligjore për kompetencat tona si organ më i lartë Komunal, në të mirë të Komunës dhe qytetarëve tonë dhe urdhëroni, nëse dikush ka vërejtje apo plotësime...

z.Refik Latifi- Këto dokumente që po i shqyrtojmë janë të bazuara në LV Lokale dhe, parimisht, pajtohemi me materialin dhe dëshiroj të ndërlihem dhe pyes lidhur me Planin e Punës-fq.4 për kryetarin dhe kryesuesin lidhur me ligjshmërsinë e akteve të Kuvendit ku thuhet se "gjatë vitit 2019, aktet që i ka miratuar Kuvendi i nënshkohen ligjshmërisë dhe i janë dërguar MAPL-së e cila ka rekomanduar rishikimin e njërit nga ata lidhur me stadiumin në "Stratorje"-Zlipotok i cili është në procedurë". Ai material, i cili i referohet MAPL-së, nuk na është dërguar neve e që, ne si Kuvend, duhet të informohemi me rekomandimet e tilla, që të dihet se ku janë gabimet e lëshimet për përmirësim të Vendimit tonë. Unë këtë e kam gjurmuar dhe kjo të jetë sugjerim për herët tjera. Ndoshta, tani është vonë, pasi se Vendimin ne e kemi miratuar më 30.07.2019 e që me Rekomandimet duhet të njoftohet Kuvendi?

z.Samidin Xheladini- Ndoshta, pos me Raporin e Planin, ekzekutivi është dashur të na paraqitet me një fjalë hyrëse, të shkurtër. Ndërkaq, në fq. 1 përmendet Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe

LV Lokale ku bazë themelore vetëqverisëse lokale është komuna e cila, sipas ligjeve, është e obligueshme që të jetë transparente për qytetarët e saj, për të marr pjesë ata në vendimmarrje. Transparenca përmenedet në 4 raste dhe duhet shtuar edhe disa fjali, si ajo se a është shtuar transparenca në Komunë, që të rritet zhvillimi ekonomik dhe klima më e volitshme politike. Edhe seancat e mbajtura (10 të rregullta dhe 1 e jashtë zakonësishme) mendoj se nuk ka kanë qenë të mjaftesueshme, pasi se kemi pasur raste kur kemi pasur shumë pika të rendit të ditës dhe materiale të gjera ku debatet kanë qenë të mangëta dhe pajtomen që të ketë më shumë seanca e më pak pika të rendit të ditës, nga se ashtu do të jepim kontribut më të madh. Po ashtu, edhe KPFinanca ka mbajtur 11 takime me 35 pika të rendit të ditës dhe ai për Komunitete po ashtu 11 me 32 pika të rendit të ditës, si dhe të kishim materialet lidhur me rishikimin e ligjshmerisë së vendimeve tona? Te Plani i Punës pajtohem, por që duhet të kemi parasysh sa më shumë takime të rregullta dhe aty sipas nevojës?

Kryesuesi- Lidhur me diskutimin e z.Refik L. reth ligjshmerisë së atij Vendimi tonë, theksohet se lënda është në procedurë e nga ne është kërkuar caktimi i lokacionit, që ne e kemi bërë dhe për ecurit tjera do të njoftohemi në të ardhmen.]

z.Zinaida Elmazi- Lidhur me pikën që po e shqyrtojmë, unë në KPFinanca dje kam theksuar se Kuvendi është organi më i lartë dhe kërkojë që për ate që po vendosim këtu të njoftohemi me materialet se ku janë bërë ndryshimet, pasi se në disa raste, delegatët e komunitetit jo shumicë, nuk ka marr pjesë në votime apo ka qenë kundër?

z.Refik Latifi- Për atë Vendim që e apostrofova, ne kemi votuar për ndryshime që i kamë gjurmuar dhe gjetur në faqen zyrtare të MAPL-së, por që ne nuk e kemi pasur ate se ku janë bërë ato ndryshime?

Kryesuesi- E qartë, por vendimet tona, me ndryshime, oonstatohen në Procesverbal dhe publikohen pas verifikimit të ligjshmerisë në web-faqen e Komunës dhe kush është për miratimin e Raportit të Punës sonë, për vitin 2019 & Planin e Punës, për vitin 2020...? "Për"-27, "kundër"-0 dhe "të përmbajta"-0 vota, që konstatoj se miratum këto dokumentet tona.

### **Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës – "eventuale"...**

Vazhdojmë me punën-pikën e III-të e rendit të ditës "eventuale", që fjalën e keni Ju të nderuar delegatë, urdhëroni...?

z.Naser Myrtezani- Kam disa pyetje për kryetarin dhe, ne, si parti politike (LDK), kërkojmë që këtë vit investimet të janë kryesisht për në shkollat e Komunës, ku kemi nevoja të mëdha. Unë, personalisht si punëtor i arsimit, e di mirë gjendjen në shkolla. Në shkollën e Zaplluxhes nuk është investuar që moti e ne si fshat e kemi projektin të cilin do të ja dërgojmë kryetarit. Në shkollën e Bresanës duhet të heqet kulmi dhe të vazhdohet edhe një kat. Edhe shkolla në Xerrxe dhe të tjera kanë nevojë të investohet. Çështje tjetër, të cilën e kam theksuar edhe më herët, janë shënimi i vijave të bardha dhe "policëve të shtrirë" para shkollave dhe se shkolla të caktuara janë në rrezik për shkak frekuencës së madhe të automjeteve, si në: Zaplluxhe, Blaç, Bresanë, Bellobrad etj. Kemi pasur disa incidente dhe me këtë propozim do të evitohej rreziku. E treta, në rrjetet sociale është paraqitur fotografia e ujkut i cili po shëtit shlrshëm në viset tona dhe atë në orët e mëngjesit në rrugën Bresanë-Buzez e që kemi kërkuar dhe kërkojnë të

sigurohen mejete për transport të nxënësëve parashiollor e deri në klasën e 5-të nga Buzezi i cili nuk e k shkollën e vetë, pasi se nxënësësit e këtij fshati janë në rrezik, nga se janë të vegjël dhe nuk kanë të gjitha mundësitë që me vetëiniciativë të transportojnë nxënësit. Po ashtu, dua të them se nuk ka nevojë, se ku po parashtrijmë pyetje dhe kërkojmë sqarime nuk ka nevojë që dikush të skuqet dhe të ndihet në siklet pasi se një person më ka ndalur duke më thënë se paskëm folur për një shkollë, rrugën, kanalizimin dhe t'u them të drejtën, më thoni se a e kam ofenduar dikend dhe quajtur hajn dhe drejtuar gishtin, pasi se gjithçka që kam thënë e kam bërë me argumente dhe me vetëdije. Nga momenti kur e marr Ftesën, nuk jam i qetë e deri vij këtu, pasi se punoj, angazhohem dhe komunikoj e pastaj flas dhe asgjë nuk flas përmendësh. Po theksoj se, e vetmja rrugë e cila ka përfunduar deri në "Liqenin e Breznes", të gjitha rrugët tjera dhe projektet nuk kanë përfunduar e mos të përmendi këtu projektet e mëdha si i ujësjiellit qendror për 15 fshatra, rrugën Zaplluxhe-"Guri i Zi", për të cilët janë ngritur "flamujt e bardhë"?!

z.Zinaida Elmazi- Kërkoj nga kryetari dhe kompetentët tjerë që të vendoset një vendkalim te shkolla "Fetah Sylejmani" në Dragash, për shkak të sigurisë së nxënësëve tonë. E dyta, pasi se kemi mjaft punëtor nga komuniteti jo shumicë, që po shkojnë në pension, kërkoj nga kryetari që më shumë t'i kushtohet rëndësi punësimit "fer-sherr" në vend të punës, që vendet nga të cilat shkojnë në pension punëtorët e komunitetit jo shumicë të punësohet nga ai komunitet dhe shiqojeni pak përqindjen në të gjitha institucionet se sa ka të punësuar nga komuniteti jo shumicë?

z.Velid Haxhisin- Dëshiroj të pyes kryetarin, pasi se është në pyetje bartja e mbeturinave, me gjendje të pandryshuar në Komunën tonë, se a ka për këtë vit ndonjë Plan me hapa konkret, që gjendja me mbeturinat të jetë disi më e rregulluar?

z.Hajrudin Hoxha- Siç e dini, unë pothuaj se gjitmonë e theksoj gjendjen e palakmuershme të rrugës Gllloboçicë-Krushevë dhe gjendjen duhet t'a kuptojmë seriozisht. E di që se ajo rrugë është nën kompetencat e MInfrastrukturës të Republikës së Serbisë (z.Nexhat Isufi- Më falë, jo të Republikës së Serbisë, por të Republikës së Kosovës!) Po po, ju kërkoj falje për këtë gabim, që më shpëtoi?! Pra, ne për atë rrugë kemi ndarë 55 mijë + 40 mijë euro për urën Krushevë-Restelicë. E dyta, Restelica ka mjaft probleme me rrugën deri në ambulancë, pasi se gjatë sezonit dimëror ajo rrugë është e pa kalueshme, ka personel të pa mjaftueshëm në punë - me një mjek, teknikun dhe pastruesin dhe pesronat e moshuar që u nevoiten analiza duhet të shkojnë në Krushevë e kjo është e pamundur gjatë sezonit dimëror, që patjetër diçka duhet ndërmarr?

z.Samidin Xheladini- Kam një kërkesë e cila nuk është në kompetencë të kryetarit, por që përmes MInfrastrukturës të gjenë zgjidhje sa më adekuate për rrugën në ndërtim Zhur-Dragash-Brod, pastaj te këthesa Zym-Bellobrad e cila duhet "të zbutet"? Po ashtu, keni vërjetur se, gjatë vozitjes natën, nuk ka sinjalizim të mjaftueshëm? Edhe tjetra, në të gjitha AMF dhe në QKMF kemi mungesë të paisjeve mjekësore dhe materialeve, që të bëhen angazhime shtesë që gjendja të përmirësohet?

z.Selman Osmani- Kam një pyetje për kryetarin dhe ajo ka të bëjë me atë se, unë çdo ditë, udhëtoj në rrugën Krushevë-Gllloboçicë-Drtagash e që gjendja është alarmane, pasi se, çdo moment, udhëtarët i janë ekspozuar rrezikut dhe kërkoj nga kryetari, që përmes DSHPublike, të ndërmeren masa për sanimin e gjendjes?

Kryetari- Do të mundohem të përgjigjem, siç kam arritur të marr shënime...Fillimisht, po theksoj se përgjegjësistë tona janë të ndara dhe se ne këtu nuk jemi për shkak të interesave tona por për ato të përgjithshme dhe unë nuk ndihem i shqetësuar nga komentet. Ne këtu jemi të thirur për të qenë të përgjegjshëm dhe shpresoj se jemi të atill, edhe pse ndonjëherë dikush nuk mund të jetë i kënaqur me përgjigjet? Sa u përket investimeve nëpër shkolla, ne i kemi të parapara ato sipas Planit Buxhetor dhe kemi edhe firmën e angazhuar për hartimin e projekteve. Jemi të vetëdijshëm se shkolla në Bresanë ka nevojë për investim, por që është pak sa investim më i madh e që do të ishet ide e mirë të paeashihet me buxhetin e vitit të ardhshëm, kurse te shkolla e Xerrxes është punuar e që ka nevojë edhe për diçka të punohet. Sa u përket vedosjeve të "policëve të shtrirë" ata janë të nevojshëm dhe për këtë jemi në biseda me drejtorët e shkollave për të paraparë nevojat. Kërkesa për transport të nxënësëve është e kahershme, por që kemi probleme me fshatrat e ndara nga shkollat amë, pasi se nevojat për këtë janë të mëdha e mundësitë e vogëla. Ju e dini se e bëjmë transportin e në pjese të nxënësëve e që kjo kërkon implikime buxhetore, që po na mungojnë, sa ka nevojë. Pajtohem me z.Zinaida E. lidhur me punësimin reciprok dhe është e drejtë, që vendet e komunitetit jop shumicë të plotësohen nga ai komunitet, dhe, atje ku ka mundësi, kjo do të zbatohet. Te rruga Krushevë-Gllboçicë e dijmë se gjendja është e vështirë, por që është vështirë të intervenohet, sepse nevojiten mjete të mëdha për t'u intervenuar përmes DSHPublike dhe atje kërkohet investim më serioz dhe jemi në kontakte me MInfrastrukturës për t'a përfshirë në buxhetin e sajë? Sa u përket punëtorëve nëpër ambulanca e QKMF ne mund të ndikojmë, por jo edhe të bëjmë punësime të reja. Sa i përket pyetjes së z.Samidin Xh. reth intervenimeve në rrugë, po theksoj se aty ku kemi parcela private është pak ma shumë problem e që nevojiten kompenzime dhe biseda me pronarët e që kontaktet duhet vazhduar edhe me punëkryesin për përmirësim të gjendjes? Ndërkaq, lidhur me shënimin e sinjalizimeve rrugore, këtë duhet bërë në kontakte me MInftrastruktues, në mungesë të mundësive vetanake. Sa u përket furnizimeve me bartna, jemi në fillim të vitit dhe ende nuk kemi informacione për nevojat dhe mundësit që kemi e për këtë do të bisedohet me drejtorin DShëndetësisë. Sa i përket pyetjes së z.Velid H. reth mbeturinave, gjendja nuk kënaq , edhe pse për këtë qëllim për pastrimine deponive kemi ndar 50 mijë euro dhe, sipas informatavë që kemi, gjendja është diçka më e mirë, por ndoshta nevojitet të aplikohet kjo, për çdo vit, për çka nga kompania pastrues kemi premtime se do të bëhen përforcime teknike përmes donacioneve, përfshi këtu edhe kontributin e fshatrave për kyçje në pastrim nga mbeturinat.


Kryesuesi- Me këtë, përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit tonë Komunal.

**E përgatiti :**

**Shërbimi i Kuvendit Komunal**

**Kryesuesi :**

**Betim Merdiu**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

LISTA

E anëtarëve-delegatëve të Kuvendit Komunal Dragash  
Çlanova-delegata Skupštine Opštine Dragaš

Nr.seancës  
Br.sednice

I-ve / 2020

Nr Br	Emri dhe mbiemri Ime i prezime	Subjekti politik Politički subjekat	Nënshkrimi Potpis
1	Betim Merdiu	PDK	
2	Shpetim Hajredini	PDK	
3	Xhemile Misinaj	PDK	
4	Artan Loshaj	PDK	
5	Bekir Qusaj	PDK	
6	Granit Rifaj	PDK	
7	Suada Bajrami	PDK	
8	Sevim Avdullahi	PDK	
9	Elira Sulejmani	PDK	
10	Samidin Xheladini	LDK	
11	Refik Latifi	LDK	
12	Sefidin Mejzini	LDK	
13	Naser Myrtezani	LDK	
14	Arijeta Skeraj	LDK	
15	Aida Misini-Halimi	LDK	
16	Adelisa Krasniqi	LDK	
17	Veljid Hadžisin	Vakat	
18	Munir Jonuzi	Vakat	
19	Zinaida Elmazi	Vakat	
20	Seljman Osmani	JGP	
21	Hatidža Šeh	JGP	
22	Lurat Krasniqi	LVetëvendosje	
23	Hajrudin Hodža	PGora	
24	Nexhat Isufi	Nisma SD	
25	Zaim Hajredini	AKR	
26	Florent Rufati	AAK	
27	Redžep Kamberi	GIG	

Dragash dt. 30.09.2020



Kryesuesi - Presedavajuci

Betim Merdiu